

Dr. Musli Vërbani

Tregime për njerëzit e devotshëm

(365 tregime për fëmijën tuaj brenda 12 muajve të vitit)

Kaçanik, 2020

Titulli:

Tregime për njerëzit e devotshëm


Autor:

Dr. Musli Vërbani

Korrektues:

Burim Bunjaku

Të drejtën e ribotimit e rezervon autori



Tregime për njerëzit e devotshëm



Një herë imam Ahmedi kishte udhëtuar për kërkim të diturisë.
Gjatë udhëtimit vendosi që pasi të falte jacinë të qëndronte në xhami.
Nga lodhja e madhe që kishte imam Ahmedin e kaploi gjumi.
Mirëmbajtësi i xhamisë po sa e vërejti, e tërhoqi për këmbësh zvarrë jashtë xhamisë.

Aty pranë ishte një furrтар.
Furrтарi kur e shikoi i erdhi keq për gjendjen e imam Ahmedit dhe e mori ta strehonte.
Kur filloi ai furrтарi që t'i ndante bukët,
imam Ahmedi e vërejti atë se gjatë punës së tij kurrë nuk pushonte nga të kënduarit
“istigfar”.

Imam Ahmedi e pyeti:

- Unë po të shoh se shumë po bën istigfar,
pa më thuaj, a ke gjetur ndonjë dobi nga istigfari?
E furrтарi i thotë:

- Vallahi nga ajo çka kam përfituar nga istigfari është se deri tani nuk ka lutje që i jam
lutur Allahut të Lartësuar e të mos e ketë pranuar, përveç një duaie që ende nuk më
është pranuar.

Imam Ahmedi e pyeti:

- Cila është ajo lutja që ende nuk të është pranuar.

Furrтарi i tha se ka dëshirë të flaktë që ta shohë imam Ahmedin.

- E kam lutur Allahun e Madhëruar që të më takojë me të, por ende nuk e kam takuar.

Imam Ahmedi i thotë:

- Vallahi lutja jote e ka tërhequr Ahmed Ibën Hanbelin zvarrë nga xhamia.

U martua Enesi, babi i imam Malikut.

Hyri dhëndër, ia shpalosi fytyrën gruas së tij, nuk i pëlqeu.

Nuk i pëlqeu sepse ajo ishte e zezë dhe jo e bukur, ai u distancua nga ajo.

Kjo gjë e lëndoi shumë gruan e tij, të cilës Allahu nuk i kishte dhënë shumë bukuri, mirëpo i kishte dhënë shumë durim dhe urtësi.

Kjo gjendje vazhdoi një kohë të gjatë dhe gruaja e vërejti se ai nuk ishte i kënaqur me të.

Ajo i tha: - **O Enes, ndoshta diçka e mirë fshihet te një e keqe.**

Kjo fjalë e qetësoi Enesin dhe u stabilizua disi, mirëpo zemra e tij ende ishte e trazuar dhe nuk jetonte i qetë.

U largua nga shtëpia duke braktisur gruan për njëzet vjet, duke mos ditur se e kishte lënë gruan shtatzënë.

Pas njëzet vjetëve, Enesi u kthye në qytetin e tij.

Para se të arrinte në shtëpi, hyri që të falej në xhami.

Aty e pa një hoxhë duke ligjëruar bukur dhe djaloshi i pëlqeu shumë.

Pyeti se kush është ky hoxhë.

I thanë imam Maliku.

Ai tha: - I kujt është ky Maliku?

Ata i thanë:

- Është djali i një njeriu i cili e ka braktisur qytetin para njëzet vjetëve, i cili quhej Enes.

Atëherë shkoi te Maliku dhe i tha: - Unë do të vij me ty në shtëpinë tënde, por do të qëndroj para derës, e ti thuaj nënës tënde se është një njeri tek dera jonë që thotë:

- **Ndoshta diçka e mirë fshihet te një e keqe.**

Kur Maliku i tha nënës së tij këto fjalë,

ajo tha:

- Vrapo dhe hapja derën, sepse ai është babai yt, është kthyer pas një udhëtimi dhe mungese të gjatë.

Ajo asnjëherë nuk ia përmendi burrit të saj braktisjen e tij.

Ajo me mund dhe sakrificë vetëmohuese e rriti, edukoi dhe shkolloi djalin e saj, dijetarin e mirënjohur, imam Malikun.

Takimi i tyre ishte shumë mallëngjyes.

Pas kësaj here, **Enesi e kuptoi se gruaja e tij ishte një margaritar i çmuar.**

Një ditë dy burra shkuan te nëna e Imam Shafijut.
I dhanë të ruante një gurë të çmueshëm.
Pas disa ditësh njëri nga këta shkoi ta merrte sendin e lënë amanet.
Nëna e imam Shafijut ngaqë kishte besim në të gjithë njerëzit,
i besoi dhe ia dha sendin që e kishin lënë amanet tek ajo dy persona.

Pas disa ditësh
shkon burri tjetër dhe kërkoi sendin e lënë amanet.
Nëna e imam Shafijut u përgjigj: - Sendin ia dhashë shokut tënd.
Burri i tha: - Por ne të patëm porositur që të mos e jepje sendin po të mos vinim e ta
kërkonim të dy bashkë. Përse atëherë ia dhe shokut tim, përderisa ai ishte vetëm.

Nëna e imam Shafijut u mërzi shumë për atë çka kishte ngjarë.
Djali e hetoi se nëna e tij vuan diçka.
E pyeti nënën e tij, pse je mërziur?
Nëna ia tregoi të birit ngjarjen,
djaloshi i mençur i tha: - Mos u mërzi nëna ime e dashur, por më lërë mua të flasë me
të.
I dha leje nëna dhe ai doli.
Kur shkoi tek burri që kërkonte sendin i tha:
- Ajo që ke lënë amanet është akoma tek ne por nuk mund të ta jap vetëm ty. Shko
thirre edhe shokun tënd e pastaj ejani t'ua jap.
**Burri u largua që aty i habitur, ndërsa të pranishmit u mahnitën me zgjuarsinë e
Shafijut.**

Një besimtar e kishte emrin Thabit.
Ishte duke marrë abdes pranë një lumi.
I vjen një kokërr molle. Sa e kafshon, pendohet!
Merr mollën dhe fillon të ecë përgjatë lumit nga kishte ardhur molla.
Arrin në një vend me mollë, ku po qëndronte një burrë.
Mollët ishin të tijat, prandaj i kërkon t'ia bëj hallall.
Burri refuzoi dhe i tha se do të pranonte vetëm nëse ai do të merrte për nuse bijën e tij,
e cila as nuk shihte, as s'dëgjonte, as nuk fliste, as nuk ecte.
Thabiti pranoi, vetëm e vetëm që të merrte hallallin.
Kur shkoi tek nusja e tij, pa se ajo shihte, dëgjonte, fliste dhe ecte për mrekulli.
I ati i vajzës e pa se u çudit dhe i tha:
- Me sytë e saj nuk sheh haram, por lexon Kur'an dhe mëson hadithet e Muhamedi a.s.
Me veshë nuk dëgjon thashetheme as fjalë të kota.
Ecën, por me këmbët e saj nuk shkon në vende të ndaluara.
Flet, por nga goja e saj nuk dalin mallkime, përgojime.
Ushqehet, por nuk ushqehet me ushqim të ndaluar.
Kisha dëshirë që Allahu të ma mundësojë ta martoj me një njeri të devotshëm dhe
mendoj se ai je ti.
Këta prindër të devotshëm ishin prindërit e dijetarit të madh, **imam Ebu Hanifes**.

Ebu Hanife dhe humbësi i thesarit

Një njeri, në një natë shkon te Ebu Hanife.

E pyet:

- O Imam, ka kohë që kam groposur thesarin diku,
por që assesi të më bie ndërmend vendi se ku!
A do të më ndihmoje në zgjidhjen e këtij problemi?

Ebu Hanife ia ktheu:

- Kjo s'është punë e fekihut (juristit).

Mirëpo, pasi u mendua thotë:

- Shko në shtëpi dhe fillo të falesh, por pa ndërprerje, deri në mëngjes,
kështu, me siguri do të të kujtohet vendi se ku i ke fshehur paratë, nëse do Allahu.

Njeriu u kthye në shtëpi,

filloi të veprojë ashtu siç e udhëzoi Imami.

Tek po falej iu kujtua vendi se ku i kishte fshehur paratë.

Me të nxituar shkoi dhe i gjeti ato.

Në mëngjes te Ebu Hanife po avitej një njeri.

Ishte po ai që e kishte harruar vendin e parave, iu afrua imamit,

i tregoi se e kishte gjetur vendin e parave dhe ia tregoi ngjarjen në tërësi,

por në fund e pyeti me shumë habi: - Si e dinit ju që unë do të kujtojë vendin e thesarit?

Imam Ebu Hanife ia ktheu:

- E dija që shejtani nuk do t'ju lë të qetë gjatë faljes dhe, me siguri, do t'ju pengonte,
duke ju bërë të kujtonit vendin e thesarit tuaj të fshehur. Po pse ju nuk e vazhduat
namazin deri në fund si falënderim ndaj Allahut për gjetjen e thesarit?

Ebu Hanife dhe tregtari

Ebu Hanife, një ditë pa një burrë që vodhi një kokërr mollë nga një tregtar.

Pasi që e kishte vjedhur ia jep një nevojtar!

Ebu Hanife iu drejtua dhe e pyeti:

- Përse e vodhe mollën?! Unë mendova se je i uritur!

Burri, iu përgjigj:

- O njeri, unë bëj tregti me Zotin tim!

Ebu Hanife e pyeti: - E si e bëke këtë tregti me Zotin?!

Burri iu përgjigj:

- Po ja. E vodha mollën?

Mu shkrua një mëkat .

Kur e dhashë sadaka, bëra një të mirë dhe një e mirë shpërblehet me dhjetë të mira.

Kështu, dhjetës i hiqet një e keqe dhe mua më mbeten nëntë të mira.

E kuptove tani?

Kjo është tregtia që bëj me Zotin!

Ebu Hanife i tha:

- Ti vodhe një mollë dhe tu shkrua një e keqe.

Vërtet që ti e dhashë sadaka, por Zoti nuk e ka pranuar këtë sadaka, sepse **Zoti është i mirë dhe nuk pranon veçse të mirën. Për fat të keq ty të ka mbetur vetëm një e keqe dhe jo nëntë të mira!**

Ebu Hanife dhe ateisti

Vjen një herë tek mbreti një ateist dhe i thotë:

- O mbret, unë nuk besoj në ekzistencën e Zotit dhe jam gati të debatoj rreth kësaj çështje me njeriun tuaj më të ditur.

Mbreti thirri dijetarin e madh Ebu Hanife. Kur i erdhi Ebu Hanifes lajmi nga mbreti, ai shkoi tek ai dhe i tha:

- O mbret, unë do të prezantoj në debat, por më parë më jep kohë të mbaroj një çështje të rëndësishme për mua në fshatin përbri dhe më pas do të kthehem menjëherë tek ty.

Mbreti e lejoi, por Ebu Hanife po vonohej shumë dhe ateisti po ndjehej fitimtar dhe i kërkoi mbretit që të largohet, sepse sipas tij as Ebu Hanifja nuk mund ta bindte atë për ekzistencën e Zotit.

Befas hyn Ebu Hanife. Ai u kërkoi falje për vonesën. Pastaj fillon dhe ua tregon arsyen e vonesës. Ebu Hanife u thotë se duke u kthyer rrugës nga fshati përbri, i duhej të kalonte një lum dhe nuk kishte asnjë varkë që ta kalonte në bregun tjetër, por duke pritur për ndonjë varkë Ebu Hanife pa një gjë shumë të çuditshme. Ai tregoi se pa drurët e pemëve të rrëzoheshin vetë, më pas të ndërthureshin me njëra-tjetrën dhe të shfaqej një çekiç që vetë filloi të mbërthejë drurët me gozhda. Në fund ai pa se si para tij u ndërtua një varkë vetë. Hipi në të dhe kaloi në bregun tjetër për të prezantuar në dialogun me ateistin.

Ateisti kur dëgjoi tregimin e Ebu Hanifes filloi të tallej dhe tha:

- Vetëm një njeri i çmendur mund ta thotë këtë fjalë dhe askush nuk mund ta besojë! Si mund të prihen drurët vetë dhe gjithashtu vetë të mbërthehen me gozhda! Si mund të ndërtohet prej tyre vetë një varkë!

Ebu Hanife buzëqeshi dhe tha:

- Nëse është e pamundur logjikisht që të besojmë se një varkë të ndërtohet vetë, atëherë si mund të besojmë logjikisht se ky univers me qiellin, tokën, diellin dhe hënën është krijuar vetë dhe pa një Krijues!

Ateisti mbeti me gojë hapur dhe tha:

- Po, me të vërtetë ky univers ka Krijuesin e tij që e krijoi dhe sistemoi në mënyrë të përsosur çdo gjë në të dhe Ai është Allahu.

Pyetjet e ateistit

Ebu Hanife i mësonte nxënësit e tij.

Në klasë hyri një ateist dhe ia parashtroi tri pyetje.

Pyetja e parë: - Si ta adhuroj Allahun kur nuk e shoh?!

Pyetja e dytë: - Si dhe pse të jap përgjegjësi për gjërat, të cilat veç m'i ka shkruar Allahu dhe unë jam i detyruar në veprimin e tyre?!

Pyetja e tretë: - Si dënohen xhinët në zjarr, kurse ata janë të krijuar prej zjarrit?!

Ebu Hanife me shpejtësi në tri pyetjet i është përgjigjur me përgjigje praktike.

Imami mori një topth të fortë prej dheu, i cili ishte afër dhe i bie ateistit me një të rënë të fortë, e cila ia shpërtheu gjakun mbi lëkurën e fytyrës.

Ateisti mendoi në vetvete, nëse e sulmon dijetarin, nuk do të ketë sukses, sepse nxënësit e tij në klasë do ta mbronin ose edhe do t'i ktheheshin në kundërsulm dhe do të vritej. Kështu e zgjodhi alternativën për ta paraqitur te gjykatësi.

Gjykatësi me të shpejtë të dy i nxori në gjykatë dhe e pyeti shejhun se pse e kishte sulmuar.

Shejhu iu përgjigj: - Kjo e rënë i është përgjigjur në tri pyetjet, të cilat m'i ka parashtruar:

E para: Ankohet për dhembjen, të cilën nuk e sheh fare, atëherë pse të mos e adhuron Allahun edhe pse nuk e sheh.

E dyta: Kur i rashë me topth të dheut, ai ka pasur të drejtë të zgjedhë: të më ofendojë ose të më mëshon, ose të ankohet te gjykatësi. Mirëpo ai e ka ditur se po të më ofendonte ose sulmonte, studentët do t'i kundërviheshin, po të më sulmonte studentët do ta mbytnin, prandaj e zgjodhi mënyrën tjetër, pra për t'u ankuar te gjykatësi. Ai është i vullnetshëm për disa çështje, ndërsa i detyruar, pa vullnetin e tij, në çështjet tjera.

E treta: Njeriu është i krijuar prej dheut të pjekur, e unë i rashë prej një topti dheu i pjekur, i cili është lëndë bazë e krijimit të njeriut. E kështu xhinët dënohen me zjarr edhe pse janë të krijuar prej zjarrit.

Malik bin Dinari dhe hajduti

Një natë, një hajdut hynë në shtëpinë e Malik bin Dinarit.
Nuk gjen asgjë për të vjedhur.
Malik bin Dinari ishte duke e falë namazin.

Sapo e mbaroi namazin e tij i thotë:
- Erdhe që të marrësh diçka të kësaj bote,
po për botën tjetër çfarë ke marrë?

Hajduti u çudit nga fjalët e dijetarit Malik bin Dinar.
Malik bin Dinarit filloi ta këshillojë.
Duke biseduar përloten të dy së bashku.
Në mëngjes shkojnë të dy në xhami.
Njerëzit i shohin.
Të habitur pyesin:
- Si ka mundësi që dijetari më i madh është bashkë me hajdutin më të madh?!

Malik bin Dinar u thotë:
- Ky njeri erdhi të na vjedhë ne, por ne ia vodhëm zemrën atij.

Uvejs Kareniju

Muhamedi a.s. ka thënë për një njeri të devotshëm:

- Ai është nga qyteti Karen, nga fisi Murad. Babai i ka vdekur, jeton vetëm me nënën dhe sillet shumë mirë me të. Ka qenë i sëmurë nga lepra, por e ka lutur Allahun për shërim dhe e ka shëruar. Nën kraharor i kanë mbetur shenjat sikur të ishin monedha dërhemit. Ai është i pari më i miri i tabiinëve.

Pastaj i ka thënë Umer bin Hatabit r.a.: - Nëse të vjen rasti dhe ke mundësi ta shohësh, lute që ai të lutet për faljen e mëkateve tua.

Kur Umeri r.a. është emëruar Emir i besimtarëve, haxhilerët nga Jemeni, në sezonin e haxhit, i pyeste: - A ka në mesin e tyre ndonjë me emrin Uvejs Karenij?

I përgjigjeshin: - Jo. Ai u thoshte: - Po pse nuk e merrni me vete?

Ata i përgjigjeshin se nuk dinin për vendbanimin e tij. E ne kemi pak ushqim dhe vetëm një palë rroba.

Umeri u thoshte atyre: - Mjerë për ju, po për ta ka folur i Dërguari i Allahut i a.s., dhe ka thënë: - **Nëse ju jepet rasti të takoheni me të, luteni që të bëjë dua për ju** (se lutja e tij pranohet).

Umeri për çdo vit e priste Uvejsin.

Dhe ndodh që një vit ai vjen me haxhilerët e Jemenit.

Umeri e takon dhe dëshiroi që ta vërtetojë atë andaj e pyet:

- Si quheni?

Uvejs – tha ai.

- Nga cili vend i Jemenit jeni?

- Nga Karni.

- Nga cili fis jeni?

- Nga fisi murad.

- Si e ke babanë?

- Babai më ka vdekur dhe jetoj vetëm me nënën.

- Si i ka marrëdhëniet me ty?

- Mundohem të sillem shumë mirë me të?

- A ke qenë i sëmurë?

- Po, Kam qenë i sëmurë prej leprës, por e kam lutur Allahun të më shërojë dhe më ka shëruar.

- A mos të ka mbetur ndonjë gjurmë e asaj sëmundje?

- Po, nën kraharorin tim kam një shenjë sa monedha e dërhemit, - pastaj ia zbuloi nënkraharorin.

Umeri pasi ia sheh atë vend, ia puth. Dhe i thotë: - Ti je ai, për cilin Pejgamberi a.s. ka thënë të lutesh për mua.

- Por, unë të lutem për ty o Emir i besimtarëve?!

Umeri i thotë: - Po.

Umeri vazhdimisht kërkonte prej tij, deri sa ai u lut për të.

Pastaj Umeri e pyet se, ku do të shkojë dhe çka do të punojë pas sezonit të haxhit.

- Unë do të shkoj te fisi Murad i Jemenit.

Umeri i thotë: - Unë do t'i shkruaj mëkëmbësit të Irakut për ty?

Uvejsi i thotë: - Të përbetohem o Emir i besimtarëve, mos vepro ashtu. Më lërë të eci në mesin e njerëzve i panjohur dhe pa ngarkesë prej tyre.

Bariu dhe Ibn Umeri

Një ditë prej ditëve, Abdullah bin Umeri me shokët e tij dalin për t'u shëtitur në periferi të Medinës.

Atë ditë bënte vapë e madhe.

Ata ndalen nën një hije që të pushojnë dhe të hanë ushqim.

Deri sa ishin ulur, aty pari kalon një bari dhe i përshëndet me selam.

Ibn Umeri e fton që t'i bashkëngjitet në ushqim.

Bariu i thotë se është agjërueshëm.

Ibni Umeri habitet dhe e pyet:

- Po përse po agjëron në këtë vapë të madhe?!

Bariu i thotë:

- Unë dëshiroj që në këtë botë të bëj sa më shumë punë të mira, që të më bëjnë dobi në botën tjetër.

Ibni Umeri i thotë:

- A po ma shet një dele?

Bariu i thotë:

- Po delet janë të pronarit tim.

Ibni Umeri i thotë:

- Thuaji pronarit se e ka ngrënë ujku.

Bariu i thotë:

- Kjo është në rregull, mund ta gënjejë pronarin tim, por Allahu më sheh, e si do të dalë atëherë para Tij në Ditën e Kijametit?

Ibni Umeri u impresionua aq shumë nga fjala e bariut dhe filloi të qajë.

Filloi të qajë nga edukata e bariut ndaj Allahut.

Pastaj shkon Ibni Umeri në Medinë, e takon pronarin e deleve.

I blen prej tij delet dhe bariun, i cili ishte rob.

Pastaj bariun e liron për Allahun dhe të gjitha delet ia jep dhuratë.

Hasani dhe Husejni

Muhamedi a.s. i kishte dy nipa.
Dy nipat e të dërguarit të Zotit janë:
- Hasani;
- Husejni.
Ata të dy janë fisnikët e të rinjve në xhenet.

Një ditë Hasani dhe Husejni panë një burrë të moshuar duke marrë abdes.
I moshuari nuk dinte të merrte abdes.
Shkojnë tek i moshuari dhe i thanë: - Ne po hahemi se kush merr abdes më mirë. A pranon të jesh gjykatës mes nesh?
I moshuari pranoi.
Të dy filluan të marrin abdes njëllë.
Të dy duke e argumentuar atë me thënie nga i dërguari i Zotit a.s.
Kur e pa këtë, i moshuari u tha:
**- Në fakt ju merrni abdes të dy shumë mirë,
jam unë ai që nuk paskam ditur të marr abdes.**

Në këtë mënyrë, ata e mësuan të moshuarin të marrë abdes siç duhej.

Bujaria e Husejnit r.a.

Një njeri shkon te Imam Husejni r.a. dhe i tha:

- Kam huazuar njëmijë dinarë dhe nuk po mundem t'i kthej në afatin e caktuar.

Imam Husejni r.a. i thotë:

- Do të ndihmoj, por më parë do t'i bëj tri pyetje:

Nëse përgjigjesh në një pyetje do ta paguaj një të tretën e borxhit tënd.

Nëse përgjigjesh në dy, do të paguaj dy të tretat.

Nëse përgjigjesh në tri pyetjet, do ta paguaj tërë borxhin tënd.

Njeriu tha:

- Në rregull, ti di më mirë se unë. Do të përgjigjem në atë që di.

Imam Husejni r.a. filloi me pyetjet:

- Çfarë është gjëja më e mirë për njeriun?

- Të besojë Allahun xh.sh.

- Cili është zbukurimi më i mirë për njeriun?

- Dituria me durim.

- Por, nëse nuk ka dituri?

- Aftësia me bujari.

- Nëse nuk e ka këtë?

- Varfëria e shoqëruar me durim dhe shpresë në Allahun xh.sh.

- Nëse nuk e ka këtë?

- Atëherë ai është sikurse dega e tharë e cila ka rënë nga pema dhe përdoret për ndezjen e zjarrit, ngase nuk mund të shfrytëzohet për asgjë tjetër.

Imam Husejni r.a. qeshi, i ofroi qesen me njëmijë dinarë dhe unazën si dhuratë duke i thënë:

- Me para paguaje borxhin, ndërsa unazën shite dhe ndihmoje familjen tënde.

Një besimtar e kishte emrin Ismail.
Përkujdesej për transmetimin e fjalëve të Muhamedit a.s.
I lind një djalë.
Djalin e emëron Muhamed.
Ismaili pas një kohe vdiq.
Përkujdesjen për Muhamedin e mori nëna e tij.
Djali humbi shikimin në moshë të re.
Ai kërkoi ndihmë nga shumë mjekë të njohur dhe të aftë të kohës së tij, por trajtimet e tyre nuk e shëruan atë.
Nëna e tij ishte adhuruese e devotshme dhe grua e drejtë.
Ajo i kërkoi ndihmë Allahut të Plotfuqishëm për fëmijën e saj dhe i kërkoi që t'ia kthente shikimin.
Më në fund, Allahu i Plotfuqishëm e pranoi lutjen e saj.
Nja natë në ëndërr ajo i bëri një vizitë Ibrahimit alejhis-selam dhe i thanë:
- Allahu ia ka kthyer shikimin djalit tënd për shkak të lutjeve të tua të forta dhe të bukura.
Në mëngjes kur Imam Buhariu u ngrit nga shtrati, në sytë e tij u shfaqën rreze drite.
Kur u bë dhjetë vjeç ai u interesua për shkencën e Hadithit.
Imam Buhariu në moshën 16-vjeçare mëson përmendësh librat e Abdullah ibn el-Mubarakut, el-Vakit dhe të shokëve të tjerë të ditur të Imam Ebu Hanifes r.a.

Rabia vinte nga një familje e varfër.
Mbeti jetime në moshë të re dhe përfundimisht përfundoi si shërbëtoreshë.
Një natë, ndërkohë që i zoti i shtëpisë ku ajo jetonte e pa atë duke u lutur gjithë natën,
e liroi nga shtëpia dhe ajo ishte e lirë.

Rabija Adevije ishte një grua muslimane,
ka qenë tepër e devotshme.

Në ditë ajo zgjohej herët në mëngjes,
merr abdes,
fal namaz,
pas përfundimit të namazit e bën këtë dua:
- O Zoti im! Për dashurinë Tënde që ke ndaj meje, falmi gabimet.

Njëri që ishte prezent i thotë: - Mos thuaj ashtu.
- Po si të them?
Thuaj: **- Për dashurinë time ndaj Teje, falmi gabimet.**

Ajo i thotë:
- Po të mos më kishte dashur Allahu nuk do të më kishte zgjuar në këtë mëngjes.
Po mos të më kishte dashur Allahu, nuk e kishte bërë këtë gjuhë që t'i lutem Atij,
Ai më ka dashur dhe m'i ka dhënë këto begati, andaj unë i lutem Atij.

Hasan Basriu dhe djali i ri

Një ditë, Hasan el-Basriu po sillej rotull Qabes në Meke.

Aty takoi një djalë të ri.

Djali i ri mbante në shpinën e tij një kosh.

E pyeti se çfarë kishte në atë kosh.

- Nënë - iu përgjigj djali i ri dhe vazhdoi:

- Jemi njerëz të varfër.

Nena ime donte të vinte në Qabe shumë kohë më parë,
por ne nuk kishim me se t'i përballonim shpenzimet e udhëtimit.

Këtë dëshirë të saj e dija mirë.

Edhe kur u plak e s'mund të udhëtonte,

Qaben nuk e hiqte nga mendja.

Çdo herë që e përmendte, sytë i mbusheshin me lot.

Nuk munda ta shoh nënën në atë gjendje.

E futa në kosh dhe e solla duke e mbajtur në shpinë prej shtëpisë tonë në Siri, e deri këtu.

Tani po i sillemi rotull Qabes.

Thonë se të drejtat e nënës janë shumë të mëdha. A thua po ia laj borxhet me këtë që bëra?

Hasan el-Basriu iu përgjigj:

- Edhe sikur ta bësh këtë punë edhe shtatëdhjetë herë të tjera, nuk lan as borxhin e një shqelmi që i ke dhënë kur ke qenë në barkun e saj.

Tarik ibn Zijadi i zbarkoi ushtarët e tij në breg.
Urdhëroi që të shkarkohej ushqim i mjaftueshëm për një ditë.
Pjesa tjetër e ushqimit të digjej bashkë me anijet.
I mbledhi ushtarët e tij dhe u tha:
- O njerëz!
Para juve është armiku.
Pas shpine e keni detin.

Po të përpiqeni për të ikur nga armiku,
s'keni rrugë tjetër veçse të mbyteni në det.

Tashmë s'kemi asnjë anije.
Po të bëheni përtacë, dijeni se s'ka ushqim për më tepër se një ditë, pas të cilës do të vdisni nga uria.
Rruga juaj e vetme është që ta mundni armikun dhe ta shkatërmoni atë.
Ushqimi juaj fshihet në luftën me armikun dhe përveç kësaj, nuk keni rrugëdalje tjetër.

Në këtë mënyrë, Tarik bin Zijadi i detyroi ushtarët e tij të luftonin.
Çfarë mundësie tjetër i mbetej një ushtari të tillë veçse të luftonte deri në pikën e fundit të gjakut të tij?

Ibn Tuluni dhe Ebu Hasani

Ibn Tulun është njëri prej udhëheqësve të Egjiptit të sotëm.
Ai ishte udhëheqës i padrejtë.
I bënte padrejtësi popullit të tij.

Njëri prej dijetarëve të atij vendi quhej Ebu Hasan.
Ebu Hasani shkon te Ibn Tulun dhe i thotë:
- Frikësoju Zotit dhe mos bën padrejtësi.

Ibn Tuluni u hidhërohet.
Prej hidhërimit e merr dijetarin dhe e burgos pa kurrfarë faji.

Ibn Tuluni e kishte një luan.
I thotë parisë së tij që mos t'i japin luanit ushqim tri ditë, deri sa të uritet shumë.
Pas tri ditëve ta dërgojnë në qelinë e dijetarit, Ebu Hasanit.

E dërgojnë luanin në qeli të dijetari dhe ia mbyllur derën.

Ata menduan se luani e ka ngrënë Ebu Hasanin.
Ndodhi e kundërta.

Kur shkojnë në burg, shohin se si dijetari falej, ndërsa luani e ruante.

Dijetari ka duruar.
Për durimin e tij Zoti e ka shpërblyer,
Luani edhe pse ka qenë i uritur nuk e ka ngrënë.
Zoti i Lartmadhëruar në Kur'an thotë:
- Dhe duro, për gjykimin e Zotit tënd, se vërtet ti je në përkujdesjen tonë.

Një natë Ebu Jezid el-Bistami u ngrit të falë namaz nate.
 Duke u falur e sheh të birin e tij pranë.
 Djali i tij ishte i vogël.
 Nata e ftohtë dhe pagjumësia e vështirë.

I tha: - O bir, bjer flejë se nata është e gjatë!
 - Po ti pse u ngrite të falesh? - pyeti djali.

- Bir, mua më duhet të ngrihem, ngase kështu ka urdhëruar Allahu xh.sh.
 Kam mbajtur mend një ajet ku Allahu xh.sh., thotë: **“Zoti yt e di se ti dhe një grup i atyre që janë me ty, kaloni në adhurim më pak se dy të tretat e natës ose gjysmën e saj, apo një tretën e saj...”**

Djali e pyet: - Kush janë ata që u falën me Muhamedin a.s.?
 Babai iu përgjigj: - Ata janë shokët e tij.
 - Nëse kështu qenka, atëherë mos më privo nga nderi i shoqërimit tënd për adhurim ndaj Allahut xh.sh. - e luti sërish djali babanë.

Babai i mahnitur i tha: - Biri im, ti je ende fëmijë dhe nuk ke arritur moshën madhore!

Djali i thotë:
 - Baba, unë kam parë se nëna ime kur donte të ndizte zjarrin,
 së pari fillonte me drunjtë e vegjël, ashtu që të ndizeshin të mëdhenjtë.
 Kam frikë se në Ditën e Gjykimit Allahu xh.sh. do të fillojë prej neve të vegjëlve, nëse ne nuk e adhurojmë Atë.

Ebu Jezidit iu mbushën sytë me lot nga frika prej Allahut.
 E lejoi të birin të falej me të dhe i tha:
 - Ngrihu, biri im dhe fale namazin, se ti ke më shumë merita tek Allahu xh.sh. sesa unë.

Xhafer bin Sadiku

Stërnipi i Pejgamberit Muhamed a.s. Xhafer Sadiku r.a.,
emri i vërtetë i të cilit ka qenë Muhamed ibn Ali ibn Husejn r.a.
E kishin quajtur “Bakir” – që do të thotë “I pastër”.
E thërrisnin dhe “Bakir el-Ulum” që do të thotë “Njeri që di dituritë e pastra.”

Një i krishterë, e ndryshonte me dashakeqësi fjalën “Bakir” në “bekare” – me kuptimin
“lopë” dhe e thërriste Xhafer Sadikun r.a. “Ente bekare” – “Ti je lopë.”

Xhafer Sadiku r.a. pa u mërzhitur dhe pa dhënë asnjë shenjë inati, iu përgjigj qetësisht: - -
Jo, unë nuk jam “bekare” (lopë), jam Bakir.

I krishteri iu kthye:

- Ti je djali i një gruaje që ishte kuzhinierë,
ajo s’kishte as turp e as nder.

Nëna jote ishte një grua e zezë, e keqe dhe e panderë.

Xhafer Sadiku r.a. i thotë:

**- Nëse këto fjalë që i thua për nënën time janë të vërteta, Zoti e mëshiroftë dhe e faltë!
Nëse fjalët e tua janë gënjeshtër, Zoti të faltë ty mëkatën që gënjeve dhe shpife për të!**

Duke parë gjithë këtë fisnikëri se si reagoi Xhafer Sadiku r.a. ndaj këtyre provokimeve të
rënda, të cilat ishin të mjaftueshme për ta nxjerrë një burrë jashtë fesë islame, i krishteri
pësoi një transformim brenda vetes dhe e ktheu veten drejt Islamit.

Më pas i krishteri u kthye në musliman.

Tregtari dhe Malik ibn Dinar

Malik ibn Dinar, shkoi në treg,
u takua rastësisht në treg me një tregtar.
Tregtarin e kishin grabitur.
Dijetari e pyeti se kush e kishte grabitur.
Tregtari i tregoi.

Mori rrugën Malik ibn Dinar dhe shkoi tek anija ku gjendeshin kusarët.
Me ta parë, ata i uruan mirëseardhjen dhe i thanë:
- Përse është munduar hoxha deri në anët tona?
Po të na kishe njoftuar, do kishim ardhur ne.

Maliku u thotë: - Kam ardhur për këtë të ngratin, të cilin e keni grabitur.

Kusarët ia kthyen mallin tregtarit.
Maliku u nis të shkojë dhe pa i falënderuar.
Kusarët i thanë: - Hoxhë efendi! Bëje një lutje për ne të gjorët.

Maliku u thotë: - Habi me ju.
1000 vetë ju mallkojnë si pasojë e padrejtësive tuaja dhe shpresoni në lutjen e një personi të vetëm?!
Prisni që të bëj lutje për ju ndërkohë që 1000 të tjerë ju mallkojnë?!
Ktheni mallrat e grabitur.
Ushqehuni me hallall.
Pastaj shpresoni tek lutjet!

Khunejd Bagdadi dhe dashuria e tij për Allahun

Ishte koha e haxhit.

Disa njerëz të mirë ishin mbledhur në Mekë dhe po kuvendonin.

Më i riu nga ta ishte Khunejd Bagdadi.

Temë e bisedës ishte **“Dashuria ndaj Allahut të Madhërishëm”**.

Bisedonin se kush ishte ai që vërtet e do Allahun e Madhërishëm.

Shumë nga ta i paraqitën opinionet e veta.

Khunejdi rrinte pa bërë zë, vetëm kujtohej, pa thënë gjë.

Shokët i thanë që të thoshte diçka.

Shokët i thanë të hapte zemrën edhe ai dhe të shprehte mendimin e vet.

Me kokën ulur dhe me lot ndër sy ai tha:

- Ai që e do Allahun e Madhërishëm është ai që e harron vetveten;

Ai gjithmonë është i zënë me të përkujtuarit e Allahut xh.sh. dhe duke i pasur parasysht e çuar në vend të gjithë urdhrat e Tij;

Ai e sheh Allahun e Lartmadhërishëm me sytë e tij të zemrës, e cila përvëlohet nga nxehtësia e frikës ndaj Tij;

Përkujtimi i Allahut xh.sh. e pushton.

Ai i flet fjalët e Allahut të Madhërishëm sikurse Ai të fliste përmes gojës së tij;

Nëse ai lëviz, këtë e bën sipas urdhrat të Allahut xh.sh.

Ai përfiton paqe në mendjen e tij vetëm përmes nënshtimit ndaj Tij dhe kur ky nivel arrihet, ai ha, pi, fle, zgjohet.

Të gjitha veprimet e tija janë për kënaqësinë e Allahut të Lartmadhërishëm.

Ai as që i merr parasysht gjërat e kësaj bote.

Ai nuk i kushton ndonjë rëndësi kritikave jo miqësore të njerëzve.

Shkaqet e mospranimi të lutjes

Ibrahim ibn Ed'hemi kalonte nëpër tregun e Basrës.

U tubuan njerëzit rreth tij dhe i thanë:

- Çka është me ne që i lutemi Allahut, por ai nuk na pranon?

Ai i thotë: - Për shkak se zemrat e juaja janë të vdekura në dhjetë çështje:

E para:

E njihni Allahun dhe nuk i kryeni obligimet e Tij.

E dyta:

Deklaroni se e doni të Dërguarin e Allahut e nuk veproni sipas sunetit të tij.

E treta:

E lexoni Kur'anin dhe nuk veproni me të.

E katërta:

I shfrytëzoni të mirat e Allahut, e nuk e falënderoni.

E pesta:

Thoni se shejtani është armiku juaj, e nuk e kundërshtoni.

E gjashta:

Thoni se xheneti është i vërtetë, e nuk punoni për të.

E shtata:

Thoni se xhehenemi është i vërtetë, e nuk largoheni prej tij.

E teta:

Thoni se vdekja është e pashmangshme, e nuk përgatiteni për çastin e tij.

E nënta:

Zgjoheni nga gjumi, i shihni të metat e të tjerëve, e i harroni tuajat.

E dhjeta:

I varrosni të vdekurit, e nuk llogaritni se do t'ju ndodhë njësoj si atyre.

Frika ndaj Allahut

Një njeri shkon te Ibrahim bin Ed'hemi dhe i thotë:

- Dua të pendohem, por pasi pendohem frikohem se prapë do të kthehem në mëkate. A më tregon si të mbrohem nga mëkatet?

Ibrahimi i thotë:

- Nëse dëshiron të bësh mëkat, mos e bëj në tokën e Allahut.

Ai i thotë:

- Po e gjithë toka është e Allahut!

Ibrahimi i thotë:

- Pasi që e di se e gjithë toka është e Allahut, atëherë mos bëj mëkate në tokën e Tij.

Pastaj Ibrahimi i thotë:

- Nëse dëshiron të bësh mëkat, mos ha prej furnizimit të Allahut.

Ai i thotë:

- Po si të jetoj, çdo gjë është furnizim prej Allahut!?

Ibrahimi thotë:

- Mirë pra, a nuk të vjen turp që ti të shfrytëzosh të gjitha begatitë dhe të mirat e Allahut dhe të bësh mëkate ndaj Tij!?

Pastaj Ibrahimi i thotë:

- Nëse dëshiron të bësh mëkat, bëje në një vend ku nuk të sheh Allahu.

Ai i thotë:

- Po ku ta gjej atë vend, kur dihet se Allahu të sheh në çdo kohë dhe çdo vend?!

Ibrahimi i thotë:

- Pasi që është ashtu, atëherë pse bën mëkat?

Pastaj Ibrahimi i thotë:

- Kur të vijë meleku i vdekjes për të ta marrë shpirtin thuaj: Më jep edhe më afat.

Njeriu i thotë:

- Po çka po thua kështu o Ibrahim, kurse Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

“Dhe kur t’i vjen (njeriut) çasti i vdekjes, nuk mund ta shtyjë fare, e as nuk mund ta shpejtojë fare”. Atëherë i thotë:

- Pasi puna është ashtu, atëherë si shpreson për të shpëtuar?!

Pastaj Ibrahimi i thotë:

- Kur të vijnë melekët e xhehenemit të quajtur Zebanije, për të të marrë dhe për të të dërguar në xhehenem, ti mos shko.

Kur njeriu e dëgjoi këtë të fundit, filloi të qajë dhe t’i thotë:

- Mjaftë më o Ibrahim, unë kërkoj falje prej Allahut dhe pendohem te Ai, dhe do ta adhuroj deri në vdekje.

Halifi dhe i urti

Një i urtë shkon tek halifi i asaj kohe.

Halifi i thotë:

- Më këshillo!

I urti i thotë:

- O udhëheqës i besimtarëve, njëherë udhëtova në Kinë dhe mbreti kinez ishte shurdhuar.

U takova me të një ditë,

e pashë duke qarë dhe më tha:

- Nuk derdh lot për shkak të humbjes së dëgjimit, por për shkak se ndonjërit që i është bërë padrejtësi do të qëndrojë në derën time duke kërkuar ndihmë e unë nuk do ta dëgjoj rënkimin e tij. Por, falënderoj Zotin që ma ka ruajtur shikimin.

Dhe ky mbret urdhëroi që tellalli të kumtonte:

- Kujt i është bërë padrejtësi, të veshë rroba të kuqe!

Mbreti kinez i hipur në elefant për çdo ditë shëtiste për të parë ndonjë që kishte rroba të kuqe, që ta mbronte nga padrejtësia që i është bërë.

O prijës i besimtarëve,

shiko këtë mbret kinez jobesimtar çfarë keqardhjeje ka ndier ndaj robërve të Zotit, andaj merr mësim!

Nuk posedon rrobë tjetër

Hilafeti i drejtuar nga udhëheqësi musliman Umer ibn Abdulazizi u zgjerua po thuajse nga Franca deri në Kinë.

Nën udhëheqjen e tij aq shumë u forcua shteti islam, si në aspekt të ekonomisë, stabilitetit dhe mirëqenies, sa të kujtonte ditët dhe kohën e Umerit r.a.

Një ditë Umer ibn Abdulazizi sëmuret.

Për ta vizituar kishte ardhur kunati i tij, pra vëllai i bashkëshortes së tij, Mesleme ibn Abdulmelik.

Kishte vërejtur se një pjesë e rrobës së Umer ibn Abdulazizit ishte e njollosur dhe se duhej pastruar ose ndërruar.

Kështu që i tha motrës që t'ia pastroj rrobën halifes.

Të nesërmen kur ishte kthyer, kishte parë se tesha e Umer ibn Abdulazizit nuk ishte ndërruar ende, andaj i kishte bërë titur me të keq së motrës:

- Fatime, a nuk të thash që të pastrosh rrobën e udhëheqësit të besimtarëve? Njerëzit po vijnë dhe e vizitojnë atë!

Ajo qetësisht i ktheu këtë përgjigje:

- **Ai nuk posedon rrobë tjetër.**

Ishte ditë e Bajramit.

Vajza e vogël e Umer ibn Abdul-Azizit hyri tek babai i saj duke qarë.

Umeri e pyeti:

- Për çka po qanë?

Vajza iu përgjigj:

- Të gjithë fëmijët kanë veshur rroba të reja, ndërsa unë edhe pse jam e bija e udhëheqësit të muslimanëve kam veshur rroba të vjetra?

Umeri i prekur nga këto fjalë të vajzës, vajti tek financieri i shtetit dhe i kërkoi që t'ia lejonte të merrte rrogën e muajit të ardhshëm.

Financieri i thotë:

- A mund të më sigurosh ti se do të jetosh dhe do të punosh muajin e ardhshëm, në mënyrë që ta marrësh rrogën e atij muaji që po e kërkon ta harxhosh tani?!

Umeri u kthye në shtëpi.

Vajza e pyeti: - Çfarë bëre baba?

Umeri iu përgjigj:

- A keni mundësi të duroni, në mënyrë që të hyjmë të gjithë së bashku në Xhenet, apo nëse ju nuk duroni unë do të hyjë në zjarr?

Vajza iu përgjigj: - **Do të durojmë baba.**

Mos të të mashtrojnë lotët

Shabiju shkon që ta viziton një mik.
Miku i tij ishte gjykatës.
Gjykatësi e merr në gjykatore.
Gjykatësi ishte i mençur.

Në gjykatore u paraqit një grua.
Ajo grua ishte grindur me një njeri.
Pak pas grindjes, lotët filluan t'i rrjedhin nga sytë.

Sha'biu i thotë gjykatësit: - A nuk e sheh duke qarë?
Vendimi duhet të jepet në favor të saj.
Asaj i është bërë padrejtësi.

Gjykatësi u përgjigj: - O Sha'bi.
Edhe vëllezërit e Jusufit a.s. vajtën në shtëpi duke qarë, ndërsa në të vërtetë ishin
gënjeshtarë.
Mos beso gjithçka që sheh.
Edhe kripa ka formën e sheqerit, por është e njelmët.

Abdullah ibn Mubareku

Një djalë i ri ishte rojtar i një plantacioni.

Një ditë pronari i plantacionit i thotë: - Ma zgjedh një shegë të ëmbël për ta ngrënë.

Ai shkon në mes të plantacionit e këput një shegë dhe ia dërgon.

Pronari fillon me ngrënë dhe e sheh se shega ishte e ithët.

Pronari i thotë për së dyti: - Bjere një tjetër.

Ai shkon në mes të plantacionit dhe ia dërgon.

Pronari fillon me ngrënë dhe e sheh se edhe shega e dytë ishte e ithët.

Pastaj pronari i thotë djaloshit: - Gati një vjet je rojtar në plantacion dhe ende nuk ke mësuar ku dhe në cilën pjesë të plantacionit janë frytet të ëmbla?

Djaloshi i thotë: - Unë paguhem për të ruajtur plantacionin dhe jo për të ngrënë nga ai.

Unë prej kohe sa jam rojtar nuk kam ngrënë asnjëherë asnjë shegë.

Pronari e vërteton se është djalë që e mbron emanetin, andaj i ofron të ia jap vajzën për grua.

Pasi martohet me vajzën e tij, nga ky çift bashkëshortor lind Abdullah ibn Mubarek r.a., njëri prej tabiinëve të njohur.

Ishte një dijetar i njohur.
Emri i tij ishte Bishr el Hafi.
Bishr el Hafi do të thotë: ai që ka ecur pa këpucë, këmbëzbathur.

Një ditë Bishri kaloi rreth rrugës.
E sheh një letër të përlyer në rrugë.
Atë letër e kishin shkelur njerëzit.
Pasi e kishin shkelur ishte bërë me baltë.
E ngriti letrën dhe e sheh se aty ishte i shkruar emri i All-llahut xh.sh.
E mori atë letër, e pastroi dhe e vendosi në një vend të lartë.

Në ëndërr një dijetarit të lartë shpirtëror i thuhet që të shkojë dhe ta lajmërojë Bishrin për të mëposhtmen:

**“O Bishr, ti e pastrove emrin Tim,
Unë ta pastrova zemrën tënde”.**

IMAM AHMEDI	7
IMAM MALIKU.....	8
IMAM SHAFIJU.....	9
BABAI I EBU HANIFES.....	10
EBU HANIFE DHE HUMBËSI I THESARIT	11
EBU HANIFE DHE TREGTARI	12
EBU HANIFE DHE ATEISTI	13
PYETJET E ATEISTIT	14
MALIK BIN DINARI DHE HAJDUTI	15
UVEJS KARENIJU	16
BARIU DHE IBN UMERI.....	17
HASANI DHE HUSEJNI	18
BUJARIA E HUSEJNIT R.A.....	19
BUHARIU	20
RABIJE ADEVIJE.....	21
HASAN BASRIU DHE DJALI I RI.....	22
TARIK IBN ZIJADI.....	23
IBN TULUNI DHE EBU HASANI	24
EBU JEZIDI.....	25
XHAFER BIN SADIKU	26
TREGTARI DHE MALIK IBN DINAR	27
XHUNEJD BAGDADI DHE DASHURIA E TIJ PËR ALLAHUN	28
SHKAQET E MOSPRANIMIT TË LUTJES.....	29
FRIKA NDAJ ALLAHUT	30
HALIFI DHE I URTI.....	31
NUK POSEDON RROBË TJETËR	32
UMER IBNU ABDULAZIZI	33
MOS TË TË MASHTROJNË LOTËT	34
ABDULLAH IBN MUBAREKU	35
BISHRI EL-HAFIJ.....	36